URDHËR
Nr. 189, datë 4.5.2022

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DEKLARATËS TIP TË NËNSHKRUAR PREJ PËRKTHYESIT ZYRTAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, si dhe të nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar",

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar sipas shtojcës bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Deklarata e përkthyesit zyrtar plotësohet në formë manuale, me shkrim dhe me shkronja kapitale, në gjuhën shqipe, nënshkruhet nga përkthyesi zyrtar dhe vuloset me vulën e tij.
3. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira dhe Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË
DEKLRATA E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Data ___.___._____

Unë, _____, përkthyes zyrtar për gjuhën _____, i certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr._____ datë ____.____._____ dhe regjistruar në Regjistrin Elektronik të Përkthyesve Zyrtarë me nr. _____, deklaroj se, kam përkthyer:

_____
_____
_____
_____
_____
_____[1],
nga gjuha e burimit _____ në gjuhën _____, me saktësi, kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore, duke ruajtur plotësisht kuptimin e fjalisë dhe përmbajtjen e tij/saj.

_____ _____

[1] Vendoset emërtesa e plotë dhe të dhëna të tjera për identifikimin e tekstit, dokumentit zyrtar, aktit normativ të miratuar në Republikën e Shqipërisë, marrëveshjes ndërkombëtare ose normave të nxjerra nga organizata ndërkombëtare.

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi **Vula**

Adresa postare: _____
Adresa elektronike: _____
Numri i kontaktit:_____